



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

V E N D I M

Nr. 16, Datë 30/01/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 112, datë 02.08.2018, e Znj. V. J. , ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”¹, “*moshës*” dhe “*gjendjes shëndetësore të bashkëshortit*”, nga ana e Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneripër Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, ankuesja V. J. , e lindur në Gramsh, në datën 20.06.1959 dhe banuese në Fier, jeton me bashkëshortin e saj dhe nënën e tij. Ankuesja thekson faktin se gjendja shëndetësore e bashkëshortit të saj është tepër e rëndë, pasi ai ka pësuar hemorragji celebrale, me pasojë humbje të memories dhe paralizë të anës së djathtë. Ndërkohë që, edhe vjehrra e saj 86 vjeçare ndodhet gjithashtu në gjendje të rëndë shëndetësore. Znj. V. J. , e cila është punonjëse e Albpetrol sh.a., nëpërmjet Vendimit nr. 531, datë 14.11.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a., është ulur në detyrë, duke e larguar nga pozicioni i Drejtores së Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së

¹Referuar kartës së anëtarësisë nr. 24484, lëshuar në datën 07.10.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim;

²Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Pronës, së kësaj shoqërie dhe duke e pozicionuar në detyrën e specialistes, në dispozicion të kësaj drejtorie, deri në një urdhër të dytë të Administratorit. Në vijim, nëpërmjet Vendimit nr. 72, datë 08.02.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., ajo është transferuar në pozicionin “ekonomiste e pagave dhe kostove”, pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos (Q.E.M.N.G. Patos). Në vijim të këtyre lëvizjeve në pozicione të ndryshme pune, në muajin korrik 2018, nëpërmjet shkresës nr.6107, datë 18.07.2018, së Administratorit të Shoqërisë, ankuesja është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me këtë shoqëri për shkak të pushimit kolektiv nga puna. Znj. V. J. rezulton se është anëtare e aktiviste dhe Kryetare e Gruas së forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

Për sa më sipër, Znj. V. J. pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve të saj politike, në kushtet kur Albpetrol sh.a. është një shoqëri, ku aksioner me 100% të aksioneve është shteti shqiptar dhe drejtohet nga një administrator, i cili është përfaqësues i forcës politike Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), e cila ka rezultuar fituese në zgjedhjet e fundit kombëtare, duke prishur koalicionin qeverisës që ka patur në një periudhë të mëparshme me LSI. Ankuesja pretendon gjithashtu se është diskriminuar gjithashtu edhe për shkak të moshës, pasi pas një periudhe 15 mujore ajo mbush moshën për pensionin e pleqërisë, si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të saj, i cili ndodhet në gjendje të rëndë, shëndetësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Në vijim të plotësimit me dokumentacionin e nevojshëm³, si dhe pas analizimit paraprak të ankesës nr. 112, datë 02.08.2018, e Znj. V. J. , u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju drejtua Albpetrol sh.a. dhe për dijeni

³Ankuesja dërgoi shkresën nr.1078/4, datë 06.08.2018, nëpërmjet së cilës plotësoi dokumentacionin e saj pranë KMD-së. Në vijim, ankuesja depozitoi edhe shkresën nr. 1235/1, datë 20.09.2018 dhe shkresën nr. 1363, datë 04.10.2018.

⁴Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin

ankueses, me shkresën nr. 1078/1, datë 17.08.2018, ku kërkohet informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesja, si dhe iu kërkua të dërgoheshin aktet e poshtëcituar:

- Informacion mbi arsyet e uljes në detyrë të Znj. V. J. dhe transferimeve të njëpasnjëshme të saj brenda shoqërisë Albpetrol sh.a.;
 - Vendimet e Administratorit, nëpërmjet së cilëve, ankuesja është emëruar/transferuar pranë kësaj shoqërie;
 - Kopje e kontratës së punës së ankueses me Albpetrol sh.a.
 - Kopje e librezës së punës së ankueses;
 - Informacion, nëse ndaj Znj. V. J. janë marrë masa disiplinore gjatë kohës që ka punuar pranë Albpetrol sh.a.;
 - Vlerësime për punën e kryer nga ankuesja ndër vite pranë Albpetrol sh.a.;
 - Informacion mbi arsyet e zbatimit të pushimit kolektiv nga puna të punonjësve të Albpetrol sh.a.;
 - Kriteret, mbi të cilat është mbështetur Albpetrol sh.a., për përzgjedhjen e punonjësve që do t'i nënshtrohen pushimit kolektiv nga puna;
 - Numri i përgjithshëm i punonjësve të Albpetrol sh.a. që do t'i nënshtrohen pushimit kolektiv nga puna.
1. Në përgjigje të shkresës nr. 1078/1, datë 17.08.2018, së Komisionerit, Administratori i Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 7111/1, datë 17.09.2018⁵, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se Znj. V. J. është punonjëse e Albpetrol sh.a., që prej datës 01.11.2013 dhe aktualisht punon në pozicionin e punës “*ekonomiste pagash dhe kostosh*” pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos. Gjatë vazhdimësisë së marrëdhënieve të punës me Shoqërinë, Znj. V. J. ka patur ndryshime të pozicionit të punës dhe në bazë të dokumentacionit zyrtar rezulton se ajo ka punuar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës*” nga data 14.11.2013 – 14.11.2017, në vijim përgjatë periudhës 14.11.2017 – 12.02.2018, ka punuar në pozicionin specialist në dispozicion të Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës. Më pas, në datën 12.02.2018, ankuesja është emëruar në pozicionin “*ekonomiste pagash dhe kostosh*” pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos, ku edhe vazhdon të punojë ende.

parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

⁵Shkresa i është dërguar për dijeni edhe ankueses V. J. .

Lidhur me ndryshimin e pozicionit të punës së Znj. V. J. , nga Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës pranë Albpetrol sh.a. në një pozicion hierarkisht më të ulët, Albpetrol sh.a. sqaron se kjo është kryer me qëllim përmirësimin e performancës së kësaj drejtorie dhe rritjen e rendimentit në punë. Duke marrë në konsideratë arsimin dhe kualifikimin e Znj. V. J. , u propozua si pozicion pune i përshtatshëm “*ekonomist page dhe kostoje*” në Qendrën e Emergjencave dhe Mjedisit Naftë dhe Gaz, Patos. Albpetrol shprehet se ankuesja ka rënë dakord me këtë pozicion pune duke vijuar punën normalisht. Kjo vërtetohet nga dokumente të ndryshme të nënshkuara prej saj, të cilat dëshmojnë ushtrimin e vazhdueshëm të detyrës. Lidhur me masat disiplinore të marra ndaj Znj. V. J. , Albpetrol sh.a. informon se mbështetur në Vendimin nr. 497, datë 14.10.2015, të Administratorit të Shoqërisë, ndaj Znj. V. J. është dhënë masë disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, sipas rekomandimeve të KLSH-së në Raportin Përfundimtar të Auditimit nr.494/20, datë 05.10.2015.

Njëkohësisht, në shkresën e Albpetrol sh.a. theksohet fakti, se ankuesja aktualisht është në afat njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të shoqërisë Albpetrol sh.a. Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me Vendimin nr.8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria “Albpetrol” sh.a. është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore. Për këtë arsye ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv, duke njoftuar punonjësit që preken nga ky proces. Nga procesi i ristrukturimit të Albpetrol sh.a. janë prekur rreth 450 punonjës, të cilët janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të kësaj shoqërie. Pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit Naftë dhe Gaz, Patos janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës 22 punonjës. Në rastin konkret, sipas strukturës së re organizative të miratuar për Qendrën e Emergjencave dhe Mjedisit Naftë dhe Gaz, Patos, pozicioni i punës “*ekonomist pagash dhe kostosh*” në administratë është shkurtuar dhe Znj. V. J. është njoftuar rregullisht me shkresën nr. 6107, datë 18.07.2018, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës, mbështetur në nenin 143 dhe 148 të Kodit të Punës. Në total janë shkurtuar 12 pozicione pune “*ekonomist*” me shpërndarje në Qendra të ndryshme të Shoqërisë. Një pjesë e tyre kanë moshë të njëjtë me ankuesen. Në këtë konteskt, Albpetrol sh.a. hedh poshtë faktin se ankuesja është diskriminuar për shkak të moshës. Për sa i përket pretendimit të ankueses për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të saj, Albpetrol sh.a. sqaron se nga ana e kësaj shoqërie, jo vetëm nuk janë ndërmarrë veprime diskriminuese ndaj ankueses, por janë ndërmarrë masa lehtësuese duke e mbështetur financiarisht atë me akordimin e ndihmës ekonomike. Për sa më sipër, mbështetur në Vendimin nr. 12, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Znj. V. J. ka

përfituar ndihmë ekonomike në vlerën 300.000 lekë për kurimin e sëmundjes së bashkëshortit. Përfitimi i kësaj ndihme ekonomike, si dhe lehtësira të tjera të krijuara nga shoqëria, në ndihmë të situatës së saj familjare, hedhin poshtë çdo pretendim për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore të familjarëve të saj.

Ndër të tjera, Albpetrol sh.a sqaron se për përzgjedhjen e punonjësve që u prekën nga pushimi kolektiv, u morën në konsideratë kritere të tilla si: arsimi, kualifikimi profesional dhe vjetërsia në punë. Në rastin e ankueses V. J. , vendi i saj i punës është shkurtuar dhe nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit apo pikëzimit sipas kritereve të mësipërme, pasi në strukturën e Qendrës ekzistonte vetëm një vend pune *“Ekonomist page dhe kostosh”*.

Bashkëlidhur shkresës nr. 7111/1, datë 17.09.2018, së Albpetrol sh.a. mungonte dokumentacioni i kërkuar nga Komisioneri.

C. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhërin nr. 168, datë 12.09.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, *“Për kryerjen e inspektimit pranë Albpetrol sh.a., për verifikimin e pretendimeve të ankueses V. J. ”*, në datën 20.09.2018, u krye inspektim pranë Albpetrol sh.a.

Gjatë inspektimit të kryer pranë Albpetrol sh.a., strukturat përgjegjëse të Shoqërisë sqaruan se ankuesja është transferuar nga pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës në pozicionin e specialistit në dispozicion të së njëjtës drejtori, e në vijim në pozicionin ekonomiste pagash dhe kostosh pranë Q.E.M.N.G. Patos, për efekt të mbarëvajtjes në punë të drejtorisë. Një fakt i tillë është reflektuar në urdhërin e emërimit të Drejtorit të ri të kësaj drejtorie. Ndërkohë që, për sa i përket çështjes së përfshirjes së saj në pushimin kolektiv që Albpetrol sh.a. po kryen në kuadër të ristrukturimit të kësaj shoqërie, strukturat përgjegjëse sqaruan se pozicioni i punës së ankueses pranë Q.E.M.N.G. Patos është shkurtuar. Në strukturën organike të Q.E.M.N.G. Patos ka patur vetëm një pozicion *“ekonomiste kostosh dhe pagash”*, pozicioni i cili mbahej nga ankuesja. Në kushtet e shkurtimit të këtij pozicioni pune, Znj. V. J. iu nënshtrua pushimit kolektiv.

Të pyetur lidhur me sistemin e vlerësimit nëpërmjet pikëzimit, strukturat përkatëse të Albpetrol sh.a.sqaruan se Znj. V. J. nuk i ishte nënshtruar vlerësimit me pikëzim, pasi pozicioni i saj i punës ishte i vetëm pranë Q.E.M.N.G. Patos. Ky sistem vlerësimi përdoret, kur suprimohen disa pozicione pune me të njëjtën emërtese dhe në këto kushte punonjësit përkatës i nënshtrohen vlerësimit me pikëzim, sipas kritereve të vendosura dhe në vijim në bazë të rezultateve përkatëse kryhet përzgjedhja e tyre, pra cilët prej tyre do t'i nënshtrohen pushimit kolektiv dhe cilët do të qendrojnë në detyrë. Pranë Q.E.M.N.G. Patos janë suprimuar vendet e punës për 3 ekonomistë,

ndërkohë që ka patur shkurtime për këtë pozicion pune edhe në Qendra të tjera të Albpetrol sh.a., përkatësisht 12 të tillë.

Inspektorët morën informacion mbi momentin, kur parashikohej që ankuesja të dilte në pension pleqërie, i cili përkonte në muajin dhjetor 2019. Strukturat përkatëse pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. sqaruan se edhe disa ekonomistë të tjerë, të cilëve iu ishte shkurtuar pozicioni i punës dhe i ishin nënshtruar pushimit kolektiv nga puna, kishin moshë të njëjtë apo të përafërt me ankuesen. Inspektorët e KMD-së morën në administrim një listë emërore të ekonomistëve të sipërpërmendur, ku reflektohej gjithashtu edhe moshë e tyre. Lidhur me pretendimin e ankueses se po diskriminohej për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të saj, Albpetrol sh.a. theksoi faktin se për t'i ardhur në ndihmë Znj. V. J. , nëpërmjet Vendimit nr. 12, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës është miratuar ndihma ekonomike në shumën 300.000 lekë për bashkëshortin e ankueses. Inspektorët administruan një kopje të vendimit të sipërpërmendur. Lidhur me masat disiplinore të ankueses, strukturat e Albpetrol sh.a u shprehën, se Znj. V. J. i është dhënë një masë disiplinore, në vitin 2015, me rekomandim të KLSH-së, masë e cila aktualisht është parashkruar. Inspektorët e KMD-së kërkuan të dispononin kopje të vlerësimeve në punë, ndër vite, të Znj. V. J. , por strukturat përkatëse të Albpetrol sh.a u shprehën se nuk kishte vlerësime të mirëfillta pune për punonjësit e Shoqërisë. Strukturat përgjegjëse të Albpetrol sh.a. u shprehën se do të dërgonin zyrtarisht, në adresë të KMD-së, Raportin e KLSH-së mbi auditimin e Albpetrol sh.a., dërguar me shkresën nr.814/15, datë 31.12.2016, ku ishin konstatuar rekomandimet e këtij institucioni ndaj Znj. V. J. .

Ndër të tjera, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se rreth 450 punonjës të kësaj shoqërie i janë nënshtruar pushimit kolektiv në punë, për shkak të ristrukturimit të saj dhe për të gjithë këta punonjës janë zbatuar me rigorozitet dispozitat e Kodit të Punës, përkatësisht nenet 143 dhe 147 të tij, lidhur me pushimin kolektiv nga puna.

1. Në vijim të inspektimit të kryer pranë Albpetrol sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1363, datë 04.10.2018, ankuesja V. J. e njofton KMD-në, se nëpërmjet Vendimit nr. 667, datë 21.09.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a. është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të saj të punës me këtë shoqëri. Referuar vendimit të mësipërm rezultoi se marrëdhëniet financiare të ankueses me Albpetrol sh.a. ndërpritën në datën 21.09.2018. Znj. V. J. thekson se përgjatë datave 21-29.09.2018, ajo ka qenë me raport mjekësor dhe Vendimi i Administratorit është miratuar në një datë kur ajo ka qenë me raport paaftësie të përkohëshme në punë, gjë që bie në kundërshtim me nenin 147, të Kodit të Punës, duke pretenduar për diskriminim për shkak të gjendjes së saj shëndetësore. Në këtë mënyrë, ankuesja ka shtuar shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ana e saj, në

ankesën nr.112, datë 02.08.2018. Bashkëlidhur shkresës së ankueses janë dërguar kopje të Vendimit nr. 667, datë 21.09.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., Raportit për paaftësi të përkohëshme në punë, si dhe shkresës nr. 7219, datë 06.08.2018, së Administratorit të Albpetrol sh.a. drejtuar Qendrave në varësi të kësaj shoqërie.

2. Albpetrol sh.a bëri kërkesë për t'u njohur me provat e depozituara nga ankuesja. Pas njohjes me provat, Albpetrol sh.a. dërgoi në adresë të Komisionerit shkresën nr. 10 224, datë 22.10.2018, ku sqaron si më poshtë:

- Lidhur me pretendimin për diskriminim të Znj. V. J. , për shkak të bindjes politike, Albpetrol sh.a. sqaron se nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj, por administron vetëm të dhëna personale bazë të punonjësve, për të cilat është marrë dhe miratimi i tyre me shkrim, sipas formularit përkatës, si dhe në përputhje me kërkesat bazë të legjisllacionit në fuqi. Albpetrol sh.a. thekson faktin se provat shkresore të paraqitura nga Znj. V. J. , që vërtetojnë bindjen e saj politike janë dokumente të panjohura për këtë shoqëri dhe të pa administruara më parë. Nga verifikimet e kryera në dosjen personale të ankueses, që disponohet nga punëdhënësi, nuk rezulton asnjë e dhënë mbi përkatësinë e saj, politike. Gjithashtu, në pamundësi për të kryer verifikime për punonjësit aktualë të shoqërisë “Albpetrol” (*nëse ka punonjës të përkatësisë politike të njëjtë me përkatësinë politike të Znj. V. J.*), Albpetrol sh.a. kërkon nga ana e Komisionerit, që ky i fundit të kryejë verifikimet e mëtejshme për të nxjerrë në pah, nëse ka elementë të diskriminimit në aspektin politik, në raport me punonjës të tjerë.

Albpetrol sh.a. shprehet se në komunikimet e mëparëshme me KMD-në, ka depozituar në cilësinë e provës, ankesa të paraqitura nga punonjës të prekur nga procesi i ristrukturimit, të cilët deklarojnë përkatësi apo bindje të ndryshme politike. Gjithashtu, Albpetrol sh.a. thekson faktin se në dijeninë e tij dhe nga informacioni zyrtar dhe publik (kandidim publik për një forcë të caktuar politike, të njëjtë me atë të deklaruar nga Znj. V. J.) janë ende në marrëdhënie pune, punonjës që kanë kandiduar zyrtarisht për forcën politike të njëjtë me atë të deklaruar nga Znj. V. J. (referuar informacioneve të siguruara nga faqja zyrtare e KQZ për listat e kandidatëve në Kuvend), fakt që tregon se në asnjë rast, marrëdhëniet e punës ndërmjet Albpetrol sh.a. dhe punonjësve të saj nuk lidhen me përkatësinë e tyre politike. Albpetrol sh.a. thekson se këto prova shkresore të paraqitura nga ana e tij, hedhin poshtë çdo pretendim të ankueses për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

- Lidhur me pretendimin e Znj. V. J. se nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, Albpetrol sh.a. sqaron se pozicioni i punës së Znj. V. J. është shkurtuar dhe

nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit apo pikëzimit sipas kriterëve të mësipërme, pasi në strukturën e Qendrës ekzistonte vetëm një pozicion pune “*Ekonomist page dhe kosto*”. Proçesi i vlerësimit dhe pikëzimit nuk mund të kryhej për Znj. V. J. , për sa kohë që pozicioni i saj i punës është i vetëm dhe nuk konkuronte, apo përballej me asnjë punonjës tjetër.

Në këtë kontekst, Albpetrol sh.a. thekson faktin se proçesi i ristrukturimit organizativ dhe reduktimit të fuqisë punëtore në Shoqërinë Albpetrol sh.a. është kryer për shkak të dorëzimit të vendburimeve të naftës dhe gazit shoqërive të tjera, si dhe nevojës për uljen e shpenzimeve totale të shoqërisë me qëllim garantimin e veprimtarisë ekonomiko-operacionale të Albpetrol sh.a. Ky proçes është kryer bazuar në parimin e transparencës, ligjshmërisë, si dhe në parimin e vlerësimit të performancës së secilit pozicion pune, duke reduktuar pozicione pune jo efikënte. Për të garantuar një proçes të rregullt dhe ligjor, këto proçedura dhe ky shkak, janë bërë publike duke zbatuar me përpikmëri legjislacionin në fuqi.

Duke patur parasysh efektin social që shkakton vetë proçedura e pushimit kolektiv është nënshkruar edhe Akt-marrëveshja me Sindikatën përfaqësuese të punëmarrësve nr. 3814, datë 03.05.2018, në të cilën janë përcaktuar kriteret mbi bazën e së cilave u zhvillua proçesi i vlerësimit dhe pikëzimit të punonjësve, si dhe u përcaktuan disa kategori punonjësish, për të cilët do të parashikohej mundësia e përjashtimit sipas rastit. Kjo Akt-Marrëveshje është pasuar me nënshkrimin e Shtojcës Nr. 1, në të cilën janë finalizuar pikat kryesore, ku do të mbështetej ristrukturimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

Albpetrol sqaron se proçesi i ristrukturimit organizativ dhe reduktimit të fuqisë punëtore është një proçes dinamik që ka prekur punonjës të profesioneve e moshave të ndryshme. Janë prekur punonjës me vendbanim në zona të ndryshme ku ushtron aktivitetin e saj shoqëria Albpetrol sh.a. Gjithashtu, efektet e tij janë shpërndarë duke prekur punonjës me vjetërsi pune në naftë të ndryshme. Konkretisht, në sqarim të pretendimit të Znj. V. J. se është diskriminuar për shkak të moshës për të përfutuar pension, ju sqarojmë së nga proçesi i ristrukturimit janë prekur 229 punonjës të moshës 55 – 65 vjeç, nga totali prej 459 punonjës të trajtuar me pushim kolektiv.

Në shkresë theksohet fakti se, mbështetur në nenin 3, të Ligjit me Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” diskriminim është: “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*”, i cili në thelb

lidhet me trajtimin e diferencuar të një personi në raport me të tjerët dhe ky trajtim i diferencuar është i lidhur me arsye fetare, etnike, racore, etj. Ndërkohë që, ndërprerja e marrëdhënieve të punës me Znj. V. J. nuk është e lidhur aspak me individin, por me një pushim kolektiv të kryer në kuadër të ristrukturimit të shoqërisë Albpetrol sh.a., i cili ka përfshirë një numër të konsiderueshëm punonjësish.

Për shkak të ristrukturimit, janë shkurtuar 12 vende pune “Ekonomist”, më shpërndarje në qendra të ndryshme të shoqërisë dhe jo vetëm në Qendrën e Emergjencave dhe Mjedisit Naftë dhe Gaz Patos. Punonjësit përkatës me vend pune “*Ekonomist*” të prekur nga ristrukturimi i shoqërisë Albpetrol sh.a., janë të moshave të ndryshme, ndërkohë që një pjesë e tyre janë me moshë të njëjtë me Znj.V. J. Sikurse duhet përmendur fakti se vazhdojnë të jenë në marrëdhënie punë në pozicione pune “ekonomist” apo pozicione të tjera pune punonjës në moshë të njëjtë me Znj.V. J. .

- Për sa i përket pretendimeve të Znj.V. J. se është diskriminuar për shkak të gjëndjes shëndetësore të bashkëshortit dhe se ndaj saj është ushtruar presion dhe për shkak të këtij presioni bashkëshorti ka shfaqur probleme shëndetësore, Albpetrol sh.a. shprehet se kërkon që Znj.V. J. të bëjë të ditur emrat e personave, të cilët kanë ushtruar presion, si dhe të provojë pretendimet e saj. Në të kundërt, ky pretendim mbetet thjesht një shprehje pa asnjë bazë të vërtetë apo të provuari.

Gjithashtu, për këtë rast, ky aspekt është edhe në interes të veçantë të shoqërisë Albpetrol sh.a. për të evidentuar dhe për të marrë masat përkatëse ligjore për punonjësit që do të diktohen si personat që kanë ushtruar presion ndaj Znj. V. J. . Albpetrol sh.a. shprehet se është detyrë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në bazë të ligjit, i ardhur në dijeni të fakteve të tilla, të kallëzojë në prokurori personat që kanë ushtruar presion ndaj Znj.V. J. , pasi ky fakt përbën element të veprës penale sipas Kodit Penal. Në të kundërt, nëse Znj.V. J. nuk evidenton faktet, rrethanat apo personat që i kanë ushtruar presion, siç pretendohet me shkrim, atëherë Komisioneri dhe Albpetrol sh.a. kanë të drejtë të kallëzojnë në Prokurori, për shpifje dhe mos kallëzim krimi, pasi në këtë rast, shoqëria ndodhet para një cënimi të madh të imazhit të shoqërisë Albpetrol sh.a., si dhe drejtuesve të saj.

- Albpetrol sh.a. shprehet se pretendimi i Znj. V. J. se është diskriminuar për shkak të gjëndjes shëndetësore të bashkëshortit është haptazi alogjik, si dhe nuk bazohet në asnjë provë apo fakt, i cili të provojë lidhjen shkakësore midis fillimit të shqetësimeve shëndetësore të bashkëshortit të saj, në muajin Tetor 2017 dhe lirimit të saj nga detyra Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, në muajin Nëntor 2017.

Ndër vite shoqëria Albpetrol sh.a. ka një qasje të veçantë për punonjësit e saj, duke ofruar ndihmë ekonomike në rast të sëmundjes së punonjësve ose familjarëve të tyre. Në rastin konkret bazuar Vendimin Nr.12 datë 07.06.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sh.a., Znj.V. J. ka përfituar ndihmë ekonomike në vlerën prej 300,000 (treqind) Lekë për kurimin e sëmundjes së bashkëshortit. Albpetrol sh.a. thekson faktin se ky fakt hedh poshtë çdo pretendim të diskriminimit për shkak të gjëndjes shëndetësore të bashkëshortit.

- Për sa i përket informacionit të paraqitur nga Znj. V. J. mbi analizën 6 mujore të shoqërisë Albpetrol sh.a., ku përmbahet informacion mbi emërimet/largimet e kryera në Albpetrol sh.a., si dhe informacione të tjera lidhur me procesin e ristrukturimit të shoqërisë Albpetrol sh.a., në shkresën e kësaj shoqërie sqarohet se ky informacion është paraqitur nga Znj. V. J. në shkelje të Kontrates Individuale të Punës, si dhe në kundërshtim me aktet e brendshme të shoqërisë Albpetrol sh.a.. Dokumentet e paraqitura nga ana e Znj. V. J. janë pjesë e Analizës 6 mujore të shoqërisë Albpetrol sh.a., e cila nuk është miratuar ende nga Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol sh.a. dhe nuk ka marrë formën e një dokumenti zyrtar.

Në respektim të të drejtave dhe detyrimeve reciproke që rrjedhin nga marrëdhënia e punës punëdhënës – punëmarrës, nga ana e Znj. V. J. duhet të paraqitej kërkesa me shkrim për disponimin e këtij informacioni në rrugë zyrtare.

Albpetrol sh.a. shprehet se, punësimet e kryera për 6 mujorin e parë të vitit 2018, janë kryer në Sektorin e Gazit të Qendrës së Prodhimit të Naftës. Sektori i Gazit të Qendrës së Prodhimit të Naftës, i cili është një sektor i ri i krijuar në kuadër të marrjes së vendburimit të gazit. Gjithashtu emërimet e tjera janë kryer në ato vende pune, plotësimi i të cilave është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punëve në shoqërinë Albpetrol sh.a.

- Për sa i përket performancës së Znj. V. J. në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës”, Albpetrol sh.a. e bën me dije Komisionerin se sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr.494/20 datë 05.10.2015 mbi auditimin e kryer në shoqërinë Albpetrol sh.a. për vitin 2014 - 2015, janë konstatuar mangësi dhe shkelje nga Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, e cila drejtohej nga Znj.V. J. . Për këtë arsye, ndaj Znj.V. J. është dhënë masë disiplinore “vërejtje me shkrim”, sipas rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë raport. Znj. V. J. është njohur me masën disiplinore dhe e ka nënshkruar atë. Gjithashtu, sërish Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin Përfundimtar Nr.814/15 Prot., datë 31.12.2016, ka rekomanduar dhënien e masës disiplinore “vërejtje deri në paralajmërim për largim nga

puna” për Znj. V. J., për shkak të shkeljeve të konstatuara nga ky institucion per Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës.

Ndërkohë, për dijeninë e KMD-së, Albpetrol sh.a. thekson faktin se edhe auditimi i fundit i KLSH-së, i kryer në shoqërinë Albpetrol sh.a. për vitin 2017, bazuar në procesverbalet e lëna dhe të nënshkruara nga audituesit e KLSH-së, evidentojnë shkelje në veprimtarinë e Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, të drejtuar nga Znj.V. J. .

- Lidhur me ankesën e paraqitur nga Znj. V. J. mbi ndryshimin e pozicionit të punës me Nr.1233 Prot datë 09.02.2018, nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a. nuk është kthyer përgjigje. Transferimi i Znj.V. J. në pozicionin e punës “Ekonomiste Page dhe Kosto” në Q.E.M.N.G. Patos, është kryer në përputhje me arsimin dhe kualifikimin e saj si pozicion pune i përshtatshëm për Znj. V. J. .

Ndër të tjera, Albpetrol sh.a. shprehet se e vlerëson të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, nga KMD, për shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura nga Znj.V. J.

D. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore mbi ankesën nr. 112, datë 02.08.2018, e Znj. V. J. , duke u mbështetur edhe në kërkesën e Albpetrol sh.a. të përcjellë me e-mail, në datën 18.10.2018, Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore në datën **01.11.2018, ora 13:00.**

Ankuesja u përfaqësua nga avokati A. H. në seancën dëgjimore pranë KMD-së, i cili depozitoi prokurën e posaçme N. Rep 2384, N. Kolek 1215/1, datë 18.10.2018, lëshuar nga notere E. L. J., nëpërmjet së cilës legjitimohej përfaqësimi i Znj. V. J. Albpetrol sh.a. u përfaqësua nga Z. Y. S., i cili depozitoi Autorizimin e Përfaqësimit nr. 10 518, datë 29.10.2018, të Administratorit të kësaj shoqërie.

Përfaqësuesi ligjor i ankueses parashtrori edhe një herë pretendimet për diskriminim të Znj. V. J. , ku theksoi faktin se si ulja në detyrë e ankueses edhe në vijim përfshirja e saj në pushimin kolektiv të Albpetrol sh.a., ka patur si shkak bindjet politike të ankueses, e cila është anëtare, aktiviste e forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim, si dhe Kryetare e Gruas së kësaj force politike në Rajonin nr. 3, të qytetit të Fierit. Zëvendësimi i saj në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës nga Z. S. K., i cili është anëtar i Partisë Socialiste dhe ka qenë kryetar i KZAZ Nr. 57, në Qarkun Fier, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Njëkohësisht, përfaqësuesi ligjor i ankueses u shpreh se në vijim ankueses i është bërë përsëri një ndryshim i dytë i pozicionit të punës pa asnjë konkurim me punonjësit e tjerë të drejtorisë ku punonte. Ndërkohë që në Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronave,

Administratori i Albpetrol sh.a. ka përzgjedhur të punojë me Z. A. B., me detyrë kryespecialist edhe pse i sapo ardhur në këtë drejtori e me më pak eksperiencë pune se Znj. V. J. . Kjo ka ndodhur për arsye se Z. A.B është djali i ish Prefektit të Qarkut Fier dhe aktualisht deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Z. Xh. B.

Përfaqësuesi ligjor i ankueses theksoi faktin se në pozicionin e punës “ekonomist pagash dhe kostosh” pranë Q.E.M.N.G. Patos ka punuar Z. D.C., i cili u transferua nga kjo qendër në Administartën Qendrore të Albpetrol sh.a., pranë Drejtorisë së Financës, pasi Z. D. C. është nipi i Kryetares së Bashkisë Patos, Znj. R.B., e cila përfaqëson PS. Në cilësinë e provës, avokati ka depozituar një fletë formati ku rezultojnë disa tabela me emërtesën numërore të disa KZAZ-ve, ku emri i Z. S.K. rezulton të jetë shënuar në përbërje të KZAZ-së nr. 57. Ndër të tjera, Avokati i ankueses u shpreh se veç diskriminimit për shkak të bindjes politike, Znj. V. J. është diskriminuar edhe për shkak të moshës, pasi ankuesja mbush moshën për pension pleqërie për 15 muaj. Ai theksoi faktin se në Aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet Albpetrol sh.a. dhe Sindikatës së Naftëtarëve fillimisht parashikohej që pushimit kolektiv nuk do t'i nënshtroheshin ata punonjës të shoqërisë që dilnin në pension pleqërie pas një periudhe 24 mujore. Por, në vijim, ky parashikim u ndryshuar nëpërmjet një Shtojce, të kësaj Akt-Marrëveshjeje, e cila u bë pjesë e Urdhërit nr 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a. Njëkohësisht, pretendimet për diskriminim të ankueses shtrihen edhe në shkakun e gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të ankueses dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të saj, pasi vendimi për largim nga puna, është dhënë në një periudhë të papërshatshme, ne referencë të nenit 147, të Kodit të Punës, pikërisht, kur Znj. V. J. ka qenë me raport për paaftësi të përkohëshme në punë.

Avokati i ankueses theksoi faktin se ndryshimet e pozicionit të punës së ankueses janë kryer pa asnjë motiv dhe shkak kryesor ka qenë bindja politike e Znj. V. J. Ai u shpreh se pas marrjes së njoftimit për largim nga puna, Znj. V. J. është ankimuar pranë Albpetrol sh.a, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga kjo shoqëri. Ai u shpreh se edhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të punonjësve, të krijuar me urdhër të administratorit, sikurse edhe anëtarët e Sindikatës së Naftëtarëve që kanë marrë pjesë në Komisionet e Vlerësimit dhe Ankesave kanë qenë anëtarë të Partisë Socialiste.

Ndërkohë që, në prapësimet e përfaqësuesit ligjor të Albpetrol sh.a. u kundërshtuan të gjitha pretendimet e avokatit të ankueses, me argumentimin se shoqëria Albpetrol sh.a. po kalonte në një proces të madh ristrukturimi, ku rreth 450 punonjës i janë nështruar pushimit kolektiv. Znj. V. J. i është shkurtuar pozicioni i saj i punës dhe si rrjedhim është përfshirë në pushimin kolektiv. Ndërkohë për sa i përket lëvizjes së saj nga pozicioni Drejtor në Drejtorisë e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronave, përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. u shpreh se shkak për këtë lëvizje kanë qenë

rekomandimet në raportet e Auditimit të KLSH-së, për auditimet e kryera në vitin 2015 për periudhën 2014-2015, auditimin e kryer në vitin 2017 dhe për periudhën 2016-2017. Ai theksoi faktin se në zbatim të këtyre rekomandimeve, Albpetrol sh.a. dha masën disiplinore “vërejtje me shkrim” për ankuesen. Ndërkohë që, edhe në auditimin e kryer nga KLSH së fundmi, Znj. V. J. ka rezultuar me shkelje të tjera dhe mund të kalojë për ndjekje penale. Ankuesja është zëvendësuar nga Z. S. K., i cili ka qenë drejtor pranë QAR Patos prej 3 vjetësh. Pra, është një punonjës aktual i shoqërisë, i cili si rezultat i performancës shumë të mirë në punë⁶, është promovuar duke u emëruar në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës së Albpetrol sh.a. Njëkohësisht, pretendimeve të përfaqësuesit ligjor të ankueses V. J. , për Z. A. B., përfaqësuesi ligjor i Albpetrol sh.a. iu përgjigj duke u shprehur se ky punonjës ka qenë sërisht punonjës i Albpetrol sh.a. prej 4 vitesh pranë QMNG Patos dhe në vijim ka kaluar Kryespecialist pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronave. Ndërkohë që, u shpreh se Z. D. C. është emëruar në Drejtorinë e Financës, jo në ish-drejtorinë e ankueses.

Përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. u shpreh se gjatë procesit të pushimit kolektiv nuk ishte marrë aspak parasysh përkatësia partiake e punonjësve të shoqërisë dhe u shpreh se pranë Albpetrol sh.a. punonin ende persona që mbanin pozicione të rëndësishme në forcën politike LSI, të tillë si Z. B. G.

D/1. Në vijim të seancës dëgjimore, Avokati me prokurë i ankueses V. J. dërgoi pranë Komisionerit shkresës nr. 1606, datë 14.11.2018, ku i bën me dije KMD-së se Z. B.G. është anëtar i Kryesisë së Sindikatës së Punonjësve të Albpetrol sh.a., prandaj edhe nuk i është nënshtruar pushimit kolektiv, pasi në referencë të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., punonjësit që janë pjesë e organeve drejtuese të SRNSH (kryesia, këshilli Drejtues, Korrinator) nuk do të prekeshin nga pushimi kolektiv.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

⁶ Albpetrol sh.a. nuk ka depozituar fakte dhe prova për të vërtetuar performancën e Z. S.K.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ankuesja V. J. , e lindur në Gramsh, në datën 20.06.1959 dhe banuese në Fier ka punuar pranë Albpetrol sh.a., që prej muajit nëntor 2013. Në bazë të dokumentacionit të depozituar në cilësinë e provës pranë Komisionerit, rezulton se ajo ka punuar përgjatë periudhës 01.11.2013 – 14.11.2017⁷, në pozicionin “Drejtor” i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, pranë Albpetrol sh.a.. Në vijim, përgjatë periudhës 14.11.2017 – 12.02.2018, Znj. V. J. ka punuar në pozicionin “*specialist në dispozicion*” të Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës. Më pas, në datën 12.02.2018, ankuesja është emëruar në pozicionin “*ekonomiste pagash dhe kostosh*”⁸ pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos. Znj. V. J. rezulton se është anëtare dhe aktiviste e forcës politike LSI, Fier, si dhe Kryetare e Gruas së kësaj force politike në Rajonin nr. 3, të qytetit të Fierit⁹.

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses, lidhur me kalimin në një pozicion pune më të ulët në hierarki.

Pretendimi i Znj. V. J. për diskriminim i ka fillesat e tij në momentin e kalimit të saj nga “*Drejtor*” e Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, ku kishte punuar për 4 (katër) vite, në pozicionin e “*specialistit në dispozicion*” të kësaj drejtorie. Referuar Vendimit nr.531, datë 14.11.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a., nëpërmjet, së cilit kryhet kalimi i ankueses nga një pozicion pune hierakisht më i lartë, në një tjetër hierakisht më të ulët, rezulton se nuk është përcaktuar asnjë motivacion për këtë lëvizje të saj. Gjatë inspektimit të kryer pranë Albpetrol sh.a., strukturat përkatëse të kësaj shoqërie janë shprehur, se motivacioni për lirim nga detyra të Znj. V. J. , është shprehur në Vendimin nr. 532, datë 14.11.2017, e Administratorit të Albpetrol sh.a., nëpërmjet së cilit është emëruar Drejtori i ri pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës. Në pikën 2, të Vendimit të sipërpërmendur citohet shprehimisht: “*Duke patur parasysh faktin se kjo drejtori ka nevojë për përmirësim, Z. S. K. ngarkohet me detyrën e evidentimit të problematikave të kësaj drejtorie dhe riformatimit të drejtorisë në funksion të mbarëvajtjeve të punëve. Me marrjen e kësaj detyre nga Z. S. K. pasi të njihet me të gjithë praktikën dhe problematikën e kësaj drejtorie në përfundim të dalë me një plan pune dhe masash për mënyrën sesi do të ecë kjo drejtori në të ardhmen.....*”.Referuar Vendimit në fjalë rezulton se Drejtorja e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës ka paraqitur problematika, të cilat tashmë i janë lënë në ngarkim për t’i zgjidhur Drejtorit të sapo emëruar, ndërkohë që në Vendimin nr. 531,

⁷Referuar Vendimit nr. 316, datë 01.11.2013. dhe Vendimit nr. 531, datë 14.11.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a;

⁸Referuar Vendimit nr. 72, datë 08.02.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a.

⁹Referuar Vërtetimit Nr. Ekstra, datë 05.11.2018, të lëshuar nga Koordinatori i LSI, Bashkia Fier.

datë 14.11.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a., ku lirohet nga detyra Znj. V. J. , nuk parashtrohet asnjë lloj motivacioni.

Nga aktet e administruara rezulton se nëpërmjet shkresës nr. 8825/8, datë 03.12.2015, të Administratorit të Shoqërisë, Znj. V. J. i është dhënë masë disiplinore “*vërejtje me shkrim*”. Kjo vërejtje është dhënë në bazë të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, drejtuar Albpetrol sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 494/20, atë 05.10.2015. Komisioneri konstatoi gjithashtu se në Raportin Përfundimtar të KLSH-së, të dërguar nëpërmjet shkresës nr. 814/15, datë 31.12.2016, në adresë të Albpetrol sh.a., rezulton se për Znj. V. J. , KLSH ka dhënë si rekomandim dhënien e masës disiplinore “*vërejtje*” deri “*paralajmërim për pushim nga puna*”, si pasojë e shkeljeve të konstatuara. Për sa më sipër, rezulton se në dy Raporte Përfundimtare të KLSH-së jepen rekomandime për dhënie masash disiplinore ndaj Znj. V. J. .

Në vijim të lirimimit nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës dhe emërimit në detyrën e specialistes në dispozicion, pranë së njëjtës drejtori, Znj. V. J. , ka kërkuar të depozitohet një ankesë për Administratorin e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në datën 18.11.2017. Për sa më sipër, ankuesja pretendon se ankesa e saj është refuzuar të protokollohet nga Zyra e Protokollit të Albpetrol sh.a., por nuk disponon asnjë provë që të vërtetojë një gjë të tillë. Kopja e ankesës së depozituar në cilësinë e provës pranë KMD-së, rezulton se është e pa protokolluar nga Albpetrol sh.a. Mbi të është shënuar “*Refuzohet 18.11.2017*”, por nuk konstatohet të jetë shënuar asnjë nënshkrim i ndonjë punonjësi të Albpetrol sh.a. Për sa kohë, që ankesa është e paprotokolluar konsiderohet se nuk është depozituar pranë Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe kjo e fundit nuk mund të penalizohet për moskthim përgjigje ndaj ankuseses.

Pas transferimit të Znj. V. J. , në pozicionin “*ekonomiste kostosh dhe pagash*” pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos, ankuesja ka depozituar sërish një ankesë tjetër për Administratorin e Albpetrol sh.a., ku kundërshton vendimin e tij. Për sa më sipër, rezulton se Administratori i Albpetrol sh.a nuk i ka kthyer përgjigje ankesës nr. 1233, datë 09.02.2018¹⁰, të Znj. V. J. Pavarësisht, refuzimit të shprehur në ankesën e saj, Znj. V. J. ka vazhduar të ushtrojë detyrën e “*ekonomistes së kostove dhe pagave*”, pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos dhe nuk e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore këtë ulje në detyrë, të cilën e konsideron të padrejtë.

¹⁰ KMD i ka kërkuar informacion Albpetrol sh.a., nëpërmjet e-mailit zyrtar, për të kryer verifikimet përkatëse nëse nga ana e kësaj shoqërie i është kthyer përgjigje ankesës së Znj. V. J. dhe kjo shoqëri nuk i ka kthyer përgjigje Komisionerit. Në këto kushte prezumohet se Albpetrol sh.a. nuk i ka kthyer përgjigje ankuseses.

Lidhur me çështjen e sipërpërmendur, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. ka barrën e provës¹¹ të provojë që lëvizjet e njëpasnjëshme të Znj. V. J. , në pozicione të ndryshme pune, aq më tepër, kur ndodhemi në kushtet e uljes në detyrë të ankueses, janë kryer për arsye të ligjshme dhe të justifikuar. Për sa më sipër, kjo shoqëri justifikohet me faktin se në adresë të ankueses ka patur rekomandime nga KLSH, si pasojë e shkeljeve të konstatuara për dhënie vërejtjesh dhe kjo ka passjellë dhe uljen e saj në detyrë.

Masa disiplinore “vërejtje me shkrim” në bazë të rekomandimeve të KLSH-së, është dhënë në vitin 2015 dhe në momentin e daljes së Vendimit nr.531, datë 14.11.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a., ajo ka qenë e parashkruar.

Mbështetur në Vendimin nr. 531, datë 14.11.2017 të Administratorit të Albpetrol sh.a. rezulton se Znj. V. J. ka kaluar në pozicionin e specialistes në dispozicion pranë së njëjtës drejtori, deri në një urdhër të dytë dhe në vijim, nëpërmjet Vendimit nr.32, datë 08.02.2018, të Administratorit të Albpetrol, ajo është transferuar në pozicionin “specialiste kostosh dhe pagash” pranë Q.M.N.G., Patos.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se për sa kohë që në Vendimin nr. 531, datë 14.11.2017 dhe Vendimin nr. 32, datë 08.02.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a nuk është shënuar motivacioni për lëvizjet në pozicione të ndryshme pune të ankueses, si dhe në kushtet kur kjo shoqëri nuk i ka kthyer përgjigje ankesës nr. 1233, datë 09.02.2018, të Znj. V. J. , në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, kjo e fundit është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a.

2. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses, lidhur me përfshirjen e saj në pushimin kolektiv nga puna, të ndërmarrë në kuadër të zbatimit të ristrukturimit të Albpetrol sh.a.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës nr. 112, datë 02.08.2018, e Znj. V. J. rezulton se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria

¹¹Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2.Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme. ”

Albpetrol sh.a.i është nështruar procesit të ristrukturimit të saj, si rrjedhim i së cilit rezulton se i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018. Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“1.Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450 të tillë, duke u konsideruar një pushim kolektiv me përmasa të konsiderueshme.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018” parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njërive të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”*

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3, të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave.

Në kushtet kur, fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë të të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t’u nënshtroheshin punonjësit e kësaj shoqërie të cilët do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., sikurse dhe Shtojcës Nr. 1¹², të lidhur ndërmjet palëve, që ka ndryshuar disa parashikime të Marrëveshjes së sipërpërmendur, kriteret, të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t'i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a. miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, e Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a..

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a., “*Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018*”, numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë është reduktuar me 22 punonjës, në krahasim me numrin e mëparshëm të punonjësve pranë kësaj qendre. Znj. V. J. punonte në pozicionin e punës “*ekonomiste kostosh dhe pagash*” pranë kësaj Qendre. Në zbatim të nenit 147, pika 5, të Kodit të Punës, me anë të shkresës

¹² Shtojca nr. 1, është pjesë integrale e Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a. për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit;

nr.6107, datë 18.07.2018, Albpetrol sh.a. e njofton Znj. V. J. , lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Në vijim, Znj. V. J. dërgon ankimin e saj nr. 6274, datë 19.07.2018, drejtuar Administratorit të Shoqërisë, ku shprehet se nuk është dakord me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke theksuar faktin se ky vendim është diskriminim politik dhe diskriminim për shkak të moshës, ndaj saj. Në përgjigje të ankesës së Znj. V. J., Albpetrol sh.a dërgoi shkresën nr.5566/1, datë 23.07.2018, nëpërmjet së cilës ankuesja sqarohet lidhur me faktin se ajo i është nënshtruar pushimit kolektiv nga puna për shkak të ristrukturimit të shoqërisë, pasi pozicioni i saj i punës është shkurtuar, por në asnjë rast ajo nuk është diskriminuar për shkak të bindjes politike dhe moshës. Në vijim, në përfundim të afatit të njoftimit, Albpetrol sh.a. i ka dërguar ankueses V. J., Vendimin nr. 667, datë 21.09.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., nëpërmjet së cilit është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të saj të punës me këtë shoqëri.

Duke iu referuar strukturës paraardhëse dhe asaj aktuale të Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve është reduktuar me 22 të tillë. Në këtë kontekst rezulton se 22 punonjës i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna, ndër të cilët edhe Znj. V. J. Pozicioni i punës së Znj. V. J. është suprimuar dhe në kushtet, kur ky pozicion pune ka qenë i vetëm, Znj. V. J. nuk i është nënshtruar vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit. Për sa më sipër, KMD gjykon se ndodhemi në kushtet e zbatimit të një procesi madhor ristrukturimi, nëpërmjet së cilit iu nënshtruan pushimit kolektiv rreth 450 punonjës të Albpetrol sh.a..

Lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja, që në momentin e miratimit të Vendimit nr. 667, datë 21.09.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., me anë të së cilit, është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës së ankueses me këtë shoqëri, Znj. V. J. ka qenë me raport paaftësie të përkohëshme në punë¹³, ndërkohë që nëpërmjet shkresës nr. 7219, datë 06.08.2018, së Albpetrol sh.a. drejtuar qendrave të tij, rezulton se kjo shoqëri i ka udhëzuar këto qendra se: *“Qendrat e Shoqërisë Albpetrol sh.a. duhet të marrin në konsideratë njoftimet e punonjësve për leje vjetore, raporte mjekësore, dhe të respektojnë afatet në përputhje me Kontratën Individuale dhe Kolektive të Punës.”*, KMD konstaton dhe gjykon se ankuesja duhet të ndjekë rrugën gjyqësore, pasi duke miratuar vendimin e sipërpërmendur, në një datë, kur Znj. V. J. ishte me raport paaftësie të përkohëshme në punë, Albpetrol sh.a. ka vepruar në kundërshtim me nenin 147, e Kodit të Punës, si dhe me përcaktimet e udhëzimet e tij, zyrtare.

¹³ Referuar Raportit për paaftësi të përkohëshme në punë, Nr. Regjistri 541, lëshuar nga Q.Sh. Nr. 1, në Fier, në datën 21.09.2018 rezulton se Znj. V. J. ka qenë me paaftësi të përkohëshme në punë përgjatë periudhës 21.09.2018-29.09.2018.

Në tërësi, në lidhje me çështjen e përfshirjes së ankueses në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a., Komisioneri gjykon se në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 112, datë 02.08.2018, e Znj. V. J. pretendohet diskriminim, për shkak të të bindjeve politike¹⁴, moshës dhe gjendjes shëndetësore të saj dhe të bashkëshortit të saj, nga ana e Albpetrol sh.a.

“Bindja politike”, “mosha” dhe “gjendja shëndetësore” janë disa prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

1. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “bindja politike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme¹⁵ që e justifikojnë si të tillë.

2. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*moshës*”, Komisioneri gjykon se “mosha” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën

¹⁴Referuar kartës së anëtarësisë nr. 24484, lëshuar në datën 07.10.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim;

¹⁵Ankuesja ka depozituar kartëne anëtarësisë nr. 24484, lëshuar në datën 07.10.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim, si dhe Kartën e Komisionerit të LSI dhe Kartën e Mandatit të Delegatit të kësaj force politike.

ligjore të sipërpërmendur. Znj. V. J. ka depozituar prova, të cilat e justifikojnë moshën¹⁶ si shkak të mbrojtur diskriminimi.

3.Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore të saj dhe të bashkëshortit të saj*”¹⁷ Komisioneri gjykon se “gjendja shëndetësore” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Znj. V. J. ka depozituar prova, të cilat e justifikojnë gjendjen shëndetësore të bashkëshortit të saj, si shkak të mbrojtur diskriminimi.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, në lidhje me transferimin e Znj. V. J. , në një pozicion hierarkisht më të ulët, me “bindjen politike”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se Znj. V. J. i është nënshtruar një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a., pasi ulja e saj në detyrë ka qenë e pamotivuar në aktin përkatës, fakt që nuk mund të konsiderohet normal, kur një shoqëri në përmasat e Albpetrol sh.a., nuk jep një motiv të mbështetur, në aktin e lëvizjes dhe uljes në detyrë të një drejtori në administratën e tij të brendshme. Sikurse është përmendur edhe më sipër, ankueses i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”¹⁸, në vitin 2015, në bazë të rekomandimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, dërguar pranë Albpetrol sh.a. me shkresën nr. 494/20, datë 05.10.2015. Njëkohësisht, në Raportin Përfundimtar të KLSH-së të përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 814/15, datë 31.12.2016, në adresë të Albpetrol sh.a., rezulton se për Znj. V. J. , KLSH ka dhënë si rekomandim dhënien e masës disiplinore “vërejtje” deri “*paralajmërim për pushim nga puna*”, si pasojë e shkeljeve të konstatuara. Ndërkohë që, rezulton se Albpetrol sh.a. nuk zbaton rekomandimin e fundit të dhënë nga KLSH, për dhënien e masës përkatëse disiplinore, por e transferon Znj. V. J. në një detyrë tjetër, më të ulët hierarkisht, gjë që nuk është rekomanduar nga KLSH.

¹⁶ Ankuesja ka depozituar kartën e identitetit, ku figuron ditëlindja e saj

¹⁷ Ankuesja ka depozituar Fletëdrejtimi për në KMCAP për Z. Vasil V. J. , Fletë-Përmbledhje e daljes nga QSUT, Shërbimi Neurovaskular për Znj. V. J. , lëshuar në datën 25.10.2017; Fletë-Përmbledhje e daljes nga QSUT, Shërbimi Neurovaskular për Znj. V. J. , lëshuar në datën 30.05.2018, si dhe Raportin për paaftësi të përkohëshme në punë, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr.1, Fier, ku vërtetohet se ajo ka qenë me raport përgjatë dative 21-29.09.2018.

¹⁸ Ankuesja ka marrë dijëni mbi masën disiplinore dhe ka nënshkruar në aktin përkatës.

Komisioneri ka analizuar rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të pasqyruara në dy Raportet Përfundimtare të Auditimit ndaj Albpetrol sh.a., por në kushtet, kur akti i uljes së detyrë të ankueses nuk i është referuar Raportit të fundit të KLSH, si dhe një motivacion i tillë nuk është reflektuar në këtë akt, ky fakt nuk mund të merret në konsideratë si i mirëqenë, duke e konsideruar që ka qenë de fakto motivacioni i munguar në aktin përkatës të nënshkruar nga Administratori i Albpetrol sh.a. Gjatë procedurës së hetimit, Komisioneri është vënë në dijeni të faktit se Znj. V. J. është zëvendësuar nga Z. S.K, i cili pas verifikimeve të kryera në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezulton se ka qenë kryetar i KZAZ-së nr. 57, në Fier, gjatë zgjedhjeve kombëtare të vitit 2017, duke përfaqësuar Partinë Socialiste. Një fakt i tillë përbën dyshim të arsyeshëm se Znj. V. J. është lëvizur nga pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Administrimit të Pronës” për motive politike, duke emëruar në pozicionin e saj të punës, një person, i cili ka një përkatësi partiake të forcës politike në pushtet, pavarësisht se ky individ ishte aktualisht punonjës i shoqërisë (drejtor në një nga qendrat e Albpetrol sh.a.)

Në këto kushte, KMD gjykon se ndryshimi i pozicionit të punës së Znj. V. J., është kryer për shkak të bindjes së saj, politike.

2. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “moshën”.

“Mosha” është shkak i pretenduar diskriminimi, që lidhet me situatën e përfshirjes së Znj. V. J. në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a. Për këtë situatë, KMD nuk konstatoi qëndrim të padrejtë dhe disfavorizues të Albpetrolit ndaj ankueses. Për këtë arsye, ky shkak nuk do të merret në analizim nga Komisioneri, pasi nuk ka lidhje me situatën e transferimit apo uljes së ankueses në detyrë, për të cilin është konstatuar se ankuesja i është ekspozuar ndaj një qëndrimi të tillë nga kjo shoqëri.

3. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “gjendjen shëndetësore të bashkëshortit të saj”.

Znj. V. J. pretendos se është diskriminuar nga Albpetrol sh. a., për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të saj, i cili ka diagnozën AVC ishemic temporal sin, kardioembolik, HTA, FA. Ndër të tjera, Znj. V. J. shprehet se kjo gjendje, bashkëshortit të saj, i ka ardhur si pasojë e stresit të përcjellë nga ana e saj në familje, për shkak të problemeve në punë, fakt që është i paprovueshëm, pavarësisht historikut të sëmundjes në dokumentin “Fletëdrejtimi për K.M.C.A.P”.

Për sa më sipër, rezulton se Albpetrol sh.a. nëpërmjet Vendimit nr. 12, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar ndihma ekonomike në shumën 300.000 lekë për bashkëshortin e ankueses. Ky fakt dëshmon që Albpetrol sh.a. nuk e ka diskriminuar ankuesen për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të saj.

1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “gjendjen shëndetësore” të ankueses.

“Gjendja shëndetësore” është shkak i pretenduar diskriminimi, që lidhet me situatën e përfshirjes së Znj. V. J. në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a. Për këtë situatë, KMD nuk konstatoi qëndrim të padrejtë dhe disfavorizues të Albpetrolit ndaj ankueses. Për këtë arsye, ky shkak nuk do të merret në analizim nga Komisioneri, pasi nuk ka lidhje me situatën e transferimit apo uljes së ankueses në detyrë, për të cilin është konstatuar se ankuesja i është ekspozuar ndaj një qëndrimi të tillë nga kjo shoqëri.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “*bindjes politike*”, të Znj. V. J. , nga ana e Albpetrol sh.a., si pasojë e transferimit të saj nga Drejtore e Drejtorisë së Ruajtjes dhe Administrimit të Pronës, në një pozicion hierarkisht më të ulët, pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos (Q.E.M.N.G. Patos).
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “*bindjes politike*”, “*moshës*” dhe “*gjendjes shëndetësore*”, së Znj. V. J. , nga ana e Albpetrol sh.a., si pasojë e përfshirjes së saj në pushimin kolektiv të zbatuar nga kjo shoqëri.

3. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “*gjendjes shëndetësore të bashkëshortit*”, së Znj. V. J. , nga ana e Albpetrol sh.a.
4. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha: Punesim

Shkak: “*bindje politike*”, “*mosha*”, “*gjendja shendetesore*”, “*gjendja shëndetësore e bashkëshortit*”